

Sviluppo Mare 1 Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021



PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2021

Nr.	AKTIVI	31/12/2021	31/12/2020
I	AKTIVET AFATSHKURTERA		
1	Aktivet monetare	8,378,392	407,022
1.1	Banka	8,378,392	407,022
1.2	Arka	0	0
2	Investime	0	0
2.1	Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit	0	0
2.2	Aksionet e veta	0	0
2.3	Te tjera Financiare	0	0
3	Të drejta të arkëtueshme	107,882,616	27,232,132
3.1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	0	0
3.2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit	0	0
3.3	Nga njësitë ekonomike ku ka pjesëmarrje	0	0
3.4	Taksa për tu arkëtuar	2,180,525	2,499,732
3.5	Të tjera të arkëtueshme	105,702,091	24,732,400
3.6	Kapital i nënshkruar i papaguar	0	0
4	Inventarët	0	0
4.1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	0	0
4.2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	0	0
4.3	Produkte të gatshme	0	0
4.4	Mallra	0	0
4.5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	0	0
4.6	AAGJM të mbajtura për shitje	0	0
4.7	Parapagime për inventar	0	0
5	Shpenzime të shtyra	214,805,882	74,692,533
6	Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	0	0
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	331,066,890	102,331,687
II	AKTIVET AFATGJATE		
7	Aktive financiare	0	0
7.1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	0	0
7.2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	0	0
7.3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka pjesëmarrje	0	0
7.4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka pjesëmarrje	0	0
7.5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	0	0
7.6	Tituj të tjerë të huadhënies	0	0
8	Aktivet materiale	37,457,874	0
8.1	Toka dhe ndërtesa	35,527,924	0
8.2	Implante dhe makineri	0	0
8.3	Të tjera Instalime dhe pajisje	1,929,950	0
8.4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	0	0
9	Aktivet biologjike	0	0
10	Aktive jo materiale:	0	0
10.1	Koncesione,patenta,liçenca,marka treg.,të drejta etj.	0	0
10.2	Emri i Mirë	0	0
10.3	Parapagime për AAJM	0	0
11	Aktive tatimore të shtyra	0	0
12	Kapitali i nënshkruar i papaguar	0	0
	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	37,457,874	0
	AKTIVE TOTALE	368,524,764	102,331,687

	DETYRIMET DHE KAPITALI	31/12/2021	31/12/2020
III	DETYRIME AFATSHKURTRA	113,386,354	103,907,767
13.1	Titujt e huamarrjes	0	0
13.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	0	0
13.3	Arkëtime në avancë për porosi	0	0
13.4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	9,443,382	17,416,002
13.5	Të tjera të pagueshme	103,911,395	84,864,811
13.6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	0	0
13.7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka pjesëmarrje	0	0
13.8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve	0	1,608,754
13.9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	31,577	18,200
14.1	<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>	20,355,093	0
14.2	<i>Të ardhura të shtyra</i>	236,374,798	0
14.3	<i>Provizione</i>	0	0
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTERA	370,116,245	103,907,767
IV	DETYRIME AFATGJATA	0	0
15.1	Titujt e huamarrjes	0	0
15.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	0	0
15.3	Arkëtimet në avancë për porosi	0	0
15.4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	0	0
15.5	Dëftesa të pagueshme	0	0
15.6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	0	0
15.7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka pjesëmarrje	0	0
15.8	Të tjera të pagueshme	0	0
16	<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>	0	0
17	<i>Të ardhura të shtyra</i>	0	0
18	<i>Grante të marra</i>	0	0
19	<i>Provizione:</i>	0	0
19.1	Provizione për pensionet	0	0
19.2	Provizione të tjera	0	0
20	<i>Detyrime tatimore të shtyra</i>	0	0
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATE	0	0
	DETYRIMET TOTALE	370,116,245	103,907,767
V	KAPITALI DHE REZERVAT	100,000	100,000
21	<i>Kapitali i Nënshkruar</i>	100,000	100,000
22	<i>Primi i lidhur me kapitalin</i>	0	0
23	<i>Rezerva rrvlerësimi</i>	0	0
24	<i>Rezerva të tjera</i>	0	0
24.1	Rezerva ligjore	0	0
24.2	Rezerva statutore	0	0
24.3	Rezerva të tjera	0	0
25	<i>Fitimi i pashpërndarë</i>	(1,676,079)	(1,676,079)
26	<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>	(15,401)	0
	TOTALI KAPITALEVE TE VETA	(1,591,480)	(1,576,079)
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	368,524,764	102,331,687

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

I	TE ARDHURAT NGA AKTIVITETI	31/12/2021	31/12/2020
30	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	0	0
31	Ndryshim gjendje prod. të gatshme dhe prod. në proces	0	0
32	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	7,973,339	1,937,637
33	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	0	0
	Totali i të ardhurave nga aktiviteti kryesor	7,973,339	1,937,637
II	SHPENZIMET PER AKTIVITETIN KRYESOR		
34	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	(820,978)	0
34.1	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	0	0
34.2	Të tjera shpenzime	(820,978)	0
35	Shpenzime të personelit	(1,203,662)	(686,546)
35.1	Paga dhe shpërblime	(1,050,696)	(588,300)
35.2	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	(152,966)	(98,246)
35.3	Shpenzime për pensionet	0	0
36	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
37	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(66,550)	0
38	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	(7,874,205)	(1,138,980)
	Totali i shpenzimeve të aktivitetit kryesor	(9,965,395)	(1,825,526)
	REZULTATI NGA AKTIVITETIT KRYESOR	(1,992,056)	112,111
III	TE ARDHURA TE TJERA (paraqit veçmas nga ato brenda grupit nëse ka)	2,317,100	2,670
39	Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	0	0
40	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera afatgjata	0	0
41	Të ardhura nga interesat dhe të tjera financiare	0	0
42	Të ardhura nga kurset e kembimit	2,317,100	2,670
43	Të ardhur nga grantet	0	0
44	Zhvlerësimi i aktiveve/investimeve financiare afatshkurtera	0	0
IV	SHPENZIME FINANCIARE (paraqit veçmas nga ato brenda grupit nëse ka)	(325,044)	(114,781)
45	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	0	0
46	Humbje nga kurset e kembimit	(289,810)	(113,875)
47	Shpenzime të tjera financiare	(35,234)	(906)
48	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	0	0
49	Rezultati neto nga Shitja AAM	0	0
	Rezultati nga aktiviteti finciar	1,992,056	(112,111)
V	FITIMI (HUMBJA) PARA TATIMIT	0	0
50	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15,401	0
50.1	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	15,401	0
50.2	Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë	0	0
50.3	Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve	0	0
VI	FITIMI (HUMBJA) E VITIT	(15,401)	0

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Sviluppo Mare 1" shpk
L61706003C

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet e Mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni në datën 01-01-2020	100,000	0	(1,676,079)		(1,576,079)		(1,576,079)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:							
Fitimi / Humbja e vitit				0	0		0
Transferime					0		0
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0		0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					0		0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0		0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					0		0
Dividendë të paguar					0		0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					0		0
Pozicioni në datën 31-12-2020	100,000	0	(1,676,079)	0	(1,576,079)	0	(1,576,079)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:							
Fitimi / Humbja e vitit			0	0	0		0
Transferime					0		0
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0		0
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					0		0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0		0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					0		0
Dividendë të paguar					0		0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					0		0
Pozicioni në datën 31-12-2021	100,000	0	(1,676,079)	0	(1,576,079)	0	(1,576,079)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2020 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Erando Hysogji
General Manager



Hartues I Pasqyrave

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

		31/12/2021	31/12/2020
I	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
	Fitim / Humbja e vitit	0	0
	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
	Shpenzimet financiare jomonetare	0	0
	Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	0	0
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	66,550	0
	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
	Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
	(Fitim) humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	0	0
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
	Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(220,763,832)	(37,216,649)
	Rënie/(ritje) në inventarë	0	0
	Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	267,801,831	84,549,929
	Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(1,608,754)	670,946
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	45,495,795	48,004,226
II	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve	0	0
	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve	0	0
	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(37,524,424)	(47,594,143)
	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	0	0
	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	0	0
	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	0	0
	Dividentë të arkëtuar	0	0
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(37,524,424)	(47,594,143)
III	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	0	0
	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral	0	0
	Hua të arkëtuara	0	0
	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	0	0
	Riblerje e aksioneve të veta	0	0
	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral	0	0
	Pagesa e huave	0	(3,061)
	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	0	0
	Interes i paguar	0	0
	Dividendë të paguar	0	0
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0	(3,061)
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	7,971,370	407,022
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim	407,022	0
	Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund	8,378,392	407,022

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Sviluppo Mare 1" shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

"Sviluppo Mare 1" sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë më datë 6 Maj 2016, në përputhje me ligjin nr. 7638, datë 19 nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare".

Shoqëria është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me NIPT L61706003C. Adresa e Shoqërisë është: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga e Dibrës, Godinë me Nr. Pasurie 7/173, ZK 8360, Kati 2, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë Sviluppo Mare 1 sh.p.k. është 100,000 Lek, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 100 lekë secila.

Ortakët e shoqërisë janë:

- Z. Redi Peza zotërues i 70 % të kuotave.
- Z. Bujar Huqi zotërues i 15 % të kuotave.
- Z. Hergys Rreli zotërues i 15 % të kuotave.

Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndërtimeve të të gjitha llojeve duke përfshirë këtu, ndërtimet civile dhe industriale, ndërtime me karakter social dhe kulturor, industrial, kanalizime, ndërtim dhe rehabilitim rrugësh, instalime elektrike, mekanike, ujsjellës kanalizime dhe elektrike, etj.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqërisë për vitin 2021 është 2 punonjës (2020: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohej nga Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Euro/ALL	120.76	123.7
USD/ ALL	106.54	100.84
GBP/ALL	143.95	137.93

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristikë të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Shoqëria nuk disponon inventar material në datën e mbylljes së pasqyrave financiare..

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Të drejta, liçensa dhe të ngjashme	Vlerë e mbetur	15 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje

dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

1. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mjete monetare:		
Llogari rrjedhëse	8,378,392	407,022
Mjete monetare në arkë	0	0
	8,378,392	407,022

3. Llogari të arkëtueshme dhe parapagime.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Klientë	0	0
Parapagime për blerje prone	81,314,806	24,732,400
Paradhenie për punonjësit	77,602	0
Tatim mbi fitimin	0	0
TVSH kreditore	2,179,874	2,499,732
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve	24,309,683	0
Të tjera tatime për t'u arketuar	651	0
	107,882,616	27,232,132

4. Inventarët

Shoqëria nuk disponon inventare në datën 31 dhjetor 2021.

5. Shpenzimet e shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Shpenzime të periudhave të ardhme Interesa të llogaritura	20,015,970	0
Shpenzime të periudhave të ardhme	30,815,864	10,441,347
Shpenzime të periudhave të ardhme Projekti	40,029,982	16,451,543
Shpenzime të periudhave të ardhme Taksat	66,514,903	205,500
Shpenzime të periudhave të ardhme pronaret informale	57,429,163	47,594,143
	214,805,882	74,692,533

"Sviluppo Mare 1" shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Mobilje dhe orendi	Pajisje Informatike	Mjete transporti	Toka	Total
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	1,996,500	35,527,924	37,524,424
Pakesime	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021	-	-	1,996,500	35,527,924	37,524,424
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	(66,550)	-	(66,550)
Nxjerje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	-	-	(66,550)	-	(66,550)
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021	-	-	1,929,950	35,527,924	37,457,874

13.4 Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Furnitorë	9,443,382	17,416,002
	9,443,382	17,416,002

13.5 Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Llogaria e ortakut		12,942,237
Debitore të tjere	103,911,395	71,922,574
Ortakët për dividendin e pa-paguar	0	0
Furnitorë për fatura të pambërritura	0	0
	103,911,395	84,864,811

13.8 Detyrime ndaj personelit

Detyrimet ndaj personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime ndaj personelit	0	1,422,298
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	186,456
	0	1,608,754

Detyrimet ndaj personelit lidhen me pagat e pagueshme.

13.9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	16,176	18,200
Tatim në Burim	0	0
Tatim mbi vlerën e shtuar	0	0
Tatim mbi fitimin	15,401	0
	31,577	18,200

14.2. Të tjera detyrime

"Sviluppo Mare 1" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të ardhura të shtyra (parapagime sipas kontratave të porosisë)	236,374,798	0
	236,374,798	0

21. Kapitali

Kapitali i shoqërisë "Sviluppo Mare 1" sh.p.k. është 100,000 Lek, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1000 lek secila.

Ortakët e shoqërisë janë: Z. Redi Peza me 70% të kuotave, Z. Hergys Rreli me 15% të kuotave, Z. Bujar Huqi me 15% të kuotave.

Administrator i shoqërisë është Z.Redi Peza.

30. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Shoqëria është në fazën fillestare të investimeve, dhe të gjithë shpenzimet e kryera gjatë periudhës kontabël, në fund të periudhës akumulohen si shpenzime të periudhave të ardhshme duke prekur llogarinë e Ndryshimit të gjëndjes.

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020. Sho

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Shitje punime ndërtimi	0	0
Shitje mallrash	0	0
Ndryshim gjendje	9,910,976	1,937,637
	9,910,976	1,937,637

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	236,374,798
Arketime ne avance per shitje pallati	-236,374,798
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	0
Ndryshim gjendje (kapitalizim shpenzimesh)	7,973,339
Të ardhura nga diferenca kursi	2,317,100
Total të ardhura të deklaruar në FDP e Tatim Fitimit	10,290,439

34.1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme.

Në këtë fazë shoqëria ende nuk ka shpenzime për mallra, lëndë të para dhe shërbime të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit.

34.2 Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Bl.energji,avull,uje	339,123	0
Qira	481,855	0
	820,978	0

35. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Shpenzime për paga dhe benefite të dhëna	1,638,996	588,300
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	251,212	98,246
	1,890,208	686,546

Shpenzimet për benefitet e përllogaritura përfshijnë rimarrjen e shpenzimeve të përllogaritura për bonuset dhe ditët e pamarra të pushimeve.

38. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Shpenzime per sigurime	42,956	0
Shpenzime te tjera	5,064,081	813,354
Shpenzime per personel jashte ndermarrjes	2,037,750	0
Sherbime bankare	665,238	64,654
Tatime te tjera	136,800	68,400
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	229,784	15,772
Shpenzime te panjohura	836,576	176,800
	9,013,185	1,138,980

46 Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Humbje nga kurset e këmbimit	403,685	113,875
	403,685	113,875

47 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
<i>Fitimi para tatimit</i>	0	0
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	909,022	177,706
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	909,022	177,706
Humbje fiskale e mbartur	-806,351	-1,145,217
	102,671	-967,511
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-15,401	0
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	0	0
Fitimi pas tatimit	87,270	-967,511

48 Transaksionet me palët e lidhura.

Shoqëria nuk ka marrdhënie tregëtare me palë të lidhura.

49 Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

50. Gabime kontabël.

Në pasqyrat financiare të vitit 2020, në zërin e aktiveve Afatgjata Materiale, përkatësisht tek Toka dhe Ndërtesa, janë paraqitur pagesat e kryera ndaj banorëve informalë në Hamallaj, sipas kontratave përkatëse të kalimit të të drejtave mbi pasuritë informale të tyre, zonën ku shoqëria planifikon të ndërtojë kompleksin turistik.

Nisur nga fakti se këto pasuri të paluajtshme janë në proces legalizimi, për ato shoqëria nuk disponon çertifikata pronësie dhe shoqëria ka si qëllim të prishë këto objekte për të vazhduar me ndërtimin e kompleksit, pra nuk ka për qëllim të përdorë, atëherë janë kryer korrigjimet përkatëse në kontabilitet, dhe të gjitha këto pagesa të kryera janë

vendosur në llogarinë " Shpenzime të periudhave të ardhme", llogari e cila do ndikojë në koston e ndërtimit të kompleksit në vitet e ardhshme.

51. Ngjarje pas bilancit

Fillimi i luftës në shtetin Ukrainas ka ndikuar në aktivitetet e biznesit dhe ekonomisë në terriore të caktuara duke përfshirë territorin e Europes dhe Shqipërisë.

Drejtimi ka marrë në konsideratë ndikimin e luftës në pasqyrat financiare, duke konsideruar nëse ndikimet e shpërthimit të saj kanë implikime pasuese të kontabilitetit dhe raportimit financiar që mund të përfshijnë jo vetëm matjen e aktiveve dhe detyrimeve, por edhe zbulimin e ngjarjeve pas datës së bilancit dhe shënimeve të tjera shpjeguese, dhe përgatitjen e pasqyrave financiare mbi bazën e vijimesise se aktivitetit.

Sigurisht që kriza e madhe që parashikohet nga mbarimi i kësaj lufte, mund të ketë impakt të madh në tregun e shitjeve të pasurive të paluajtshme gjatë vitit 2022, megjithatë duke besuar se kjo situatë do të përfundojë shumë shpejt dhe duke ndjekur një politikë të kujdesshme të çmimeve të shitjes e shoqëruar me një politikë të kujdesshme të shpenzimeve të administrimit nuk do të ketë impakt në fitimin e parashikuar, ashtu siç nuk do të afektojë asnjë nga treguesit financiarë.

Drejtimi gjykon se ky event nuk ka asnjë impakt në lidhje me aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të raportuara në pasqyrat financiare më 31.12.2021, dhe se as mund të çënojë vijueshmerinë e aktivitetit të shoqërisë.

